

E SHTUNA E SHEN LAZARIT

Pas të Gjashtë Psallmeve në mengjes këndohet:

PERLESHORJA E SHEN LAZARIT, T.I.

Vërtetove Ngjalljen e përbashkme përpara Pësimit tënt, e ngrite Lazarin prej së vdekurësh, o Krisht Perëndi; përandaj dhe ne posi djemat, dyke mbajtur shenjat e mundjes, ty po të thërresim mundësit të vdekjes: Hosanna ti më të lartat, i bekuar je ti që vjen, me emrin e Zotit. **(3 herë)**

NDENJESORET

PAS TU LITHU SFRAJISTHENTOS

T.I. Mëshirove Marinë edhe Marthën që qanin, edhe urdhërove ta heqin, nga der' e varrit gurin; e ngrite Lazarin me një zë, o Zoti Jesu Krisht o Perëndi. Lavdi fuqisë sate Shpëtimtar, lavdi përdëllimit tënt; lavdi Mbretërisë sate, i vetëm njeridashës.

LAVDI DHE TANI. Gjithajo.

PAS TON SINANARKHON LOGON

T.T.I. O burim i së mirës dhe i mëshirave, pyete Marthën të motrën ku ish i vdekuri; dhe kur të shpunë derdhe lot për mikun tënt; thirre pastaj me zë të math, dhe e ngjalle për çudi, të vdekur prej katër ditësh; njeridashës dhe jetëdhënës, o Shpëtimtar o Perëndi dhe Zot.

LAVDI DHE TANI. Gjithajo.

SHKURTORJA, T. II.
PAS TA ANO ZITON

Jesuj Perëndi, gëzim' i të gjithëve, dhe drit' e shkëlqim, dhe ngjallj' e gjithë njerësve, përmi dhenë u-çfaq tani, dhe sipas mirësisë tij, na dha shëmbëllsinë e Ngjalljes së nesërme, mëshirën dhe ndjesën e mëkatave.

SHTEPIA

Krijetari u thoshte Dishepujve: Vëllezër, miku ynë fle. Ejani pra ta shikojmë varrin, dhe ta pushojmë vajtimin e motrave; se atje kam për të bërë një çudi, si parëthënie për Kryqin dhe ndjesën e mëkatave.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Shtunën përpara Pallmave, kremtojmë Ngjalljen e Shën Lazarit, mikut të Krishtit.

Me nërmjetimet e Shën Lazarit mikut tënt, o Krisht o Perëndi, mëshirona dhe shpëtona. Amin.

ZBRITESORET, T.T.IV.
IGRAN DHIODHEFSAS

I. U-hoth nëpër detin si në stere, shpëtoj nga tirani, nga armiku Egjiptian, populli i mjerë dhe thërriste: Lavdi më ty Shpëtimtar Perëndi dhe Zot.

III. Kryemjeshër i qjellit, o Kryezot Krijetar, që ndërtove Kishën e shenjtë, ti na shiguro, se ti na do dhe na ndih, ti i dëgjon mëkatarët, ti besnikët përher' i mpron, ti njeridashësi.

IV. Kam dëgjuar o Zoti Krisht, qysh e regullove këtë mister të math, kupëtova vepërimin tënt, Shën Mari o Hyjlindëse, ti që na ke lindur kapëdanin e math, zbut-e shqotën e pësimeve, qetësoji valat e mëkatave.

V. Dritë na dhuro, dhe tregona udhën ti o Zot, me porrositë dhe me krahun tënt, dhe paqen tënde dhurona o mik i njerësve.

VI. Të falurit Perëndisë do tja shtronj, dhe ati do tja tregonj hidhërimet, se plot me vrer, shpirti im është mbushur, dhe jeta ime ka zbritur përposh në Ferr, dhe lutem si Jonaj në det: Prej greminës më nxir Perëndi dhe Zot.

VII. Të tre djemat e Judesë, që rastisnë të ndodhen në Babillonë një mot, nga besa e Trinisë, e shkelnë flagën djegëse të furrës me lavdërim: O Perëndi Shpëtimtar, o Zot je i bekuar.

VIII. Zotin dhe Mbretin tonë qjellor të bekuar, ushtëri ëngjëllore hymnoni, dhe e lartësoni me zë për gjithë jetët.

IX. O Nën' e Perëndisë, Zonjë Virgjëreshë, që na shpëtove me anën e Zotit Jesu, të madhështojmë me gjith' ushtërit' e Engjëjve.

DERGIMESORET, T. III.
PAS EPESKEPSATO IMAS

Me një fjal' o Shpëtimtar, e ngjalle prej së vdekur-ësh, mikun e dashur Lazarin tënt, të vdekur që prej katër ditsh; ty pra të priti populli, me degë dhe me lule, si Mbret dhe si Perëndi. (3 herë)

LAVDERIMET, T. I.

O Krisht o jetë dhe ngjallje, qëndrove përpara varrit të Lazarit, si Perëndi dhe si njeri, i lindur prej Virgjëreshës. Si njeri pyete ku ishte varrosur, dhe si Perëndi e ngjalle me një fjalë, të vdekurin prej katër ditësh. (2 herë)

E ngjalle Lazarin prej Ferrit, dhe e trondite mbretërin' e vdekjes. Përandaj të lavdërojmë: I bekuar je o Shpëtimtar, mëshirona.

Fjalën që i the Marthës, që ti je ngjallja dhe jeta, e provove me vepër, kur e thirre Lazarin prej Ferrit. Ashtu o Njeridashës, ngjall-më dhe mua nga varri i pasioneve.

LAVDI, T. II. Një çudi e madhe u-bë sot, se Krishti thirri prej varrit, një të vdekur prej katër ditësh, dhe e ngjalli mikun përsëri; le ta lavdërojmë dhe le t'i lutemi, me nërmjetimet e Shën Lazarit, t' i shpëtonjë shpirtet tona.

TANI. E përmibekuar je, o Hyjlindëse Virgjëreshë. Të hymnojmë, se prej Birit që linde, Ferri u-robërua, Adami u-nduall prapë, mallkimi vdiq, Eva u-çlirua, vdekja u-dërmua, dhe ne muarmë jetë. Përandaj po hymnojmë, dhe thërresim: I bekuar je, o Krisht Perëndi, që e pëlqeve kështu, lavdi më ty.

Doksollogji e Madhe. Në Hyrjen këndohet tri herë:

PERLESHORJA E SHEN LAZARIT, T. I.

Vërtetove Ngjalljen e përbashkme përpara Pësimit tënt, e ngrite Lazarin prej së vdekurësh, o Krisht

Perëndi; përandaj dhe ne posi djemat, dyke mbajtur shenjat e mundjes, ty po të thërresim mundësit të vdekjes: Hosanna ti më të lartat, i bekuar je ti që vjen, më emrin e Zotit. (3 herë)

HYRTORJA

Ejani t'i falemi dhe t'i përgjunjemi Zotit Krisht. Shpëtona, o i Bir' i Perëndisë, që u-ngjalle së vdekurësh, ne që të këndojmë Alilluia.

SHKURTORJA, T. II.

PAS TA ANO ZITON

Jesuj Perëndi, gëzim' i të gjithëve, dhe drit' e shkëlqim, dhe ngjallj' e gjithë njerësve, përmi dhenë u-çfaq tani, dhe sipas mirësisë tij, na dha shëmbëllsinë e Ngjalljes së nesërme, mëshirën dhe ndjesën e mëkatave.

Në vëndin e Hymnit Trishenjtor këndohet:

Sa u-pagëzuar më Zotin Krisht, u-veshtë me Zotin Krisht Alilluia. (3 herë)

Lavdi Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shenjtë.

Tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve, Amin.

U-veshtë me Zotin Krisht, Alilluia.

Sa u-pagëzuar më Zotin Krisht, u-veshtë me Zotin Krisht, Alilluia.

APOSTULLI

Zoti është drita dhe shpëtimi im.

Zoti është mprojtësi i jetës sime.

Këndimi prej Letrës së Palit për Hebrejtë.

Vëllezër, dyke marrë një mbretëri të patundur, le të kemi hirin, me të cilin e adhurojmë Perëndinë me një mënyrë të pëlqyer, me nder dhe me frikë. Se Perëndia është zjarr që shkrin. Vëlladashja le të mbetet. Mos e harroni huajpritjen, se kështu disa veta kanë pritur Engjëj pa ditur. Kujtoni të burgosurit, si të burgosur me ta, edhe ata, që vuajnë të këqia, sikur të ishit edhe ju vetë në trupin e tyre. Martesa është e nderçime për të gjithë, dhe shtrati i pacinuar; po Perëndia do t'i gjykonjë lavirarët edhe adulltarët. Silluni pa argjëndashje; kënaquni me ato, që kini tani, se ay vetë ka thënë: “Nukë do të lë, as do të neverit kurrë.” Kështu munt të themi me kuxim: “Zoti është ndihmësi im, dhe nukë do të kem frikë se ç’ do më bënë njeriu.” Kujtoni të parët tuaj, të cilët ju kanë folur fjalën e Perëndisë; imitojeni besën e tyre, dyke marrë përpara sysh përfundimin e jetesës së tyre. Jesu Krishti është gjithay die dhe sot edhe për jetë.

UNGJILLI PAS JOANIT

Më atë kohë, ishte një njeri i sëmure, i quajtur Lazar prej Bethanisë, katundit të Marisë dhe motrës së saj Marthës. Maria ishte ajo, që lyejti Zotin me myrrë, dhe ia fshiu këmbët me flokët e veta, dhe i-vëllaj Lazari ishte i sëmure. Të motrat, pra, i dërguan fjalë, dhe i thanë: “Zot, miku yt i dashur është i sëmure.” Dhe Jesuj, kur e dëgjoj, tha: “Kjo sëmurdje nuk është për vdekje, po për lavdinë e Perëndisë, që të lavdërohet i Biri i Perëndisë me anën e saj.” Edhe Jesuj e deshte Marthën edhe të motrën edhe Lazarin. Kur dëgjoj pra që ishte i sëmure, mbeti edhe dy ditë në atë vënt, ku

ishte. Pastaj u tha dishepujve: “Le të kthehemi prapë në Jude.” Edhe dishepujtë i thanë: “Rabbi, Judenjtë tani afër deshnin të të vrisnin me gurë, edhe do prapë të kthehesh në Jude?” Edhe Jesuj u-përgjeq: “A nukë ka dymbëdhjetë orë dita? Nëqoftëse njeriu ecën ditën, nukë rrëshket, se sheh dritën e kësaj bote; po nëqoftëse njeriu ecën natën, rrëshket, se nukë ka dritë.” Pas këtyre fjalëve u tha: “Miku ynë Lazar ka fjetur, po do të vete ta zgjonj.” Dishepujtë, pra, i thanë: “Zot, nëqoftëse ka fjetur, ahëre do të shpëtonjë.” Dhe Jesuj fliste për vdekjen e tij, po ata kujtonin se fliste për fjetjen e gjumit. Ahëre, pra, Jesuj u tha hapur: “Lazari ka vdekur; dhe gëzohem që nuk isha atje, se tani kini për të besuar; po le të vemi tek ay.” Thomaj, pra, i cili quhej Binjak, u tha shokëve dishepuj: “Le të vemi edhe ne, që të vdesim me atë.” Kur ardhi, pra, Jesuj e gjeti që kishte qënë katër ditë në varr. Dhe Bethania ishte nja pesëmbëdhjetë stade lark Jerusalem-it. Edhe shumë Judenj kishin ardhur në shtëpinë e Marthës edhe Marisë, që t'i ngushëllonin për vëllanë e tyre. Martha, pra, kur dëgjoj që po vinte Jesuj, i doli përpara, edhe Maria mbeti në shtëpi. Martha, pra, i tha Jesujt: “Zot, po të ishe këtu, im-vëlla nukë do të kishte vdekur; po edhe tani e di që Perëndia do të japë ç’ t'i lypësh.” Edhe Jesuj i tha: “Yt-vëlla do të ngrihet.” Martha iu-përgjeq: “E di që do të ngrihet në Ngjalljen në ditën e funtme.” Jesuj i tha: “Unë jam ngjallja dhe jeta; ay, që më beson, do të rronjë pas vdekjes. Dhe cilido, që rron dhe më beson, nukë ka për të vdekur fare. A e beson këtë?” Dhe Martha iu-përgjeq: “Po, o Zot, unë besonj se ti je Krishti, i Bir i Perëndisë, që ke ardhur në botë.” Dhe passi tha këto fjalë, shkoj, edhe thirri tinës të motrën Marinë,

dyke thënë: “Mësonjësi ka ardhur, dhe të thërret.” Edhe ajo, kur e dëgjoj, u-ngrit me vrap, edhe vajti tek ay. Se Jesuj nukë kishte arrirë në katundin, po ndodhej edhe në vëndin, ku i dolli përpara Martha. Judenjtë, pra, të cilët ishin në shtëpi që ta ngushëllonin, kur e panë Marinë, që u-ngrit me vrap edhe dolli jashtë, i ranë pas, dyke thënë se vente në varrin, që ta qante të vëllanë. Maria, pra, kur ardhi atje, ku ishte Jesuj, edhe e pa, i ra nër këmbë, dhe i tha: “Zot, po të ishe këtu, im-vëlla nukë do të kishte vdekur.” Jesuj, pra, kur e pa që po qante ajo edhe Judenjtë, që kishin ardhur tok me atë, iu-përzie shpirti, dhe u-trubullua, dhe tha: “Ku e kini vënë?” Dhe ata iu-përgjeqnë: “Eja dhe shiko.” Edhe Jesuj qau. Judenjtë, pra, thoshin: “Shiko se sa e deshte.” Po disa prej atyre thoshin: “Vallë nukë muntte ta ndalonte këtë vdekje ky, që ia çeli sytë të verbërit?” Jesuj, pra, dyke psherëtitur, arriu në varrin, i cili ishte një shpellë me një gur, të vënë përmi të. Edhe Jesuj u tha: “Ngrereni gurin.” Edhe Martha, e motra e të vdekurit, i tha: “Zot, po bie erë tani, se është që prej katër ditësh aty.” Edhe Jesuj iu-përgjeq: “A nukë të thashë që, nëqoftëse beson, do ta shikosh lavdinë e Perëndisë?” E ngritnë, pra, gurin s’ andejmi, ku ishte vënë i vdekuri. Dhe Jesuj i ngriti sytë për-pjetë, dhe tha: “Atë, të përhironj, se më dëgjove. Dhe unë e dinja që më dëgjon përherë; po e thashë për gjindjen, që rri rrotull, që të besojnë se ti më ke dërguar.” Dhe passi tha këto fjalë, bërrtiti me zë të math. “Lazar, dil jashtë!” Dhe dolli i vdekuri, i lidhur këmb’ e duar me savan; dhe fytyra e tij ishte e pështjellur me një rizë. Dhe Jesuj u tha: “Zgjidheni, dhe lereni të baresë.” Shumë, pra, prej Judenjve, që

që kishin ardhur në shtëpinë e Marisë, dhe i panë ato, që bëri Jesuj, e besuan.

Pastaj vazhdon Mesha e Shën Joan Gojartit. Në “Veçan Tërëshenjten”, këndohet Madhështimi pasonjës në Tingëllin Tërthor IV:

PAS TIN IPSILLOTERAN

Le ta lavdërojmë Zonjën Mari, Nënë Virgjëreshë, që ka mbajtur në gji të saj, zjarrin e pashuar dhe mbeti e padjegur, me këngë të paprera, le ta nderojmë sot.

KUNGATORJA

Nga goja e foshnjave dhe thithanikëve gatite lavdërim. Alilluia, alilluia, alilluia.

Në vënt të “Pamë Dritën” këndohet Përlëshorja e Shënjtit.